



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-CC-2020-11

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratorja: Fidelma Donlon

Data: 22 shtator 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për caktimin e panelit të Gjykatës Kushtetuese

Gjykatësve të Dhomave të Specializuara të Gjykatës Kushtetuese

Gjykatës Vidar Stensland

Gjykatës Antonio Balsamo

Gjykatës Roumen Nenkov

Kryetares së Kuvendit të Kosovës:

Zj. Vjosa Osmani-Sadriu

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të nenit 33(3), 49(2) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullës 4(b) të Rregullores së Punës së Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, dhe rregullës 3(4) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktim”), cakton gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (“DHSGJK”) për të vendosur në lidhje me referimin e përcjellë nga Kryetarja e Kuvendit të Kosovës.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 17 shtator 2020, Autoriteti Emërues caktoi gjykatësin Antonio Balsamo dhe gjykatësin Roumen Nenkov si gjykatës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese

2. Më 18 shtator 2020, Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, në pajtim me nenin 144(3) dhe 162(3) të Kushtetutës së Kosovës, kërkoi që Kryetarja t’i caktojë Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, një referim në lidhje me amendamentin e propozuar kushtetues që ka të bëjë me Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Referimi”).¹

II. CAKTIMI

3. Në pajtim me rregullën 4(2) të Rregullores për Caktim, Kryetarja është siguruar se tre gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese janë në dispozicion për kryerjen e detyrës.

¹ F00001, Letër nga Kryetarja e Kuvendit të Kosovës dërguar Kryetares së DHSK-së, 18 shtator 2020, me Aneks (F00001/A01). Referimi u protokollua më 21 shtator 2020.

4. Kryetarja gjithashtu e ka shqyrtuar kërkesën e Kryetares së Kuvendit të Kosovës për t'ia caktuar referimin që është përcjellë në pajtim me nenin 162(3) të Kushtetutës, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, NË VIJIM, KRYETARJA ÇAKTON

në panelin e Gjykatës Kushtetuese këta gjykatës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, për të vendosur në lidhje me referimin:

Gjykatës Vidar Stensland

Gjykatës Antonio Balsamo

Gjykatës Roumen Nenkov

_____/nënshkrim/_____

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Kryetare e Dhomave të Specializuara

E martë, 22 shtator 2020

Në Hagë

Holandë